

Standardi Ndërkombëtat i Raportimit Financiar 7

Instrumentat Financiarë: Dhënie Informacionesh Shpjeguese

Objektivi

- 1 Objektivi i këtij SNRF është që t'u kërkojë njësive ekonomike që të japin informacione shpjeguese në pasqyrat e tyre financiare, të cilat u mundësojnë përdoruesve të vlerësojnë:
 - (a) rëndësinë e instrumentave financiarë për pozicionin financiar dhe për performancën financiare të një njësie ekonomike; dhe
 - (b) natyrën dhe madhësinë e risqeve që vijnë nga instrumentat financiarë, ndaj të cilëve ekspozohet njësia ekonomike gjatë periudhës dhe në datën e raportimit si edhe sesi njësia ekonomike i manaxhon këto risqe.
- 2 Parimet në këtë SNRF plotësojnë parimet për njohjen, matjen dhe paraqitjen e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare në SNK 32 *Instrumentat Financiarë: Paraqitja* dhe SNK 39 *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja*.

Objekti

- 3 Ky SNRF duhet të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha llojet e instrumentave financiarë me përjashtim të:
 - (a) interesave në filiale, pjesëmarrje dhe shoqëritë e përbashkëta të cilat trajtohen në përputhje me SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Veçanta*, SNK 28 *Investime në Pjesëmarrje* ose SNK 31 *Interesa në Shoqëritë e Përbashkëta*. Megjithatë në disa raste, SNK 27, SNK 28 ose SNK 31 lejon që një njësi ekonomike të trajtojë interesat në një filial, pjesëmarrje ose shoqëri të përbashkët duke përdorur SNK 39; në këto raste, njësitë ekonomike duhet të zbatojnë edhe kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të SNK 27, SNK 28 ose SNK 31, përveç atyre të këtij SNRF. Njësitë ekonomike duhet të zbatojnë këtë SNRF për të gjithë derivativët e lidhur me interesat në filiale, pjesëmarrje ose shoqëri të përbashkëta, me përjashtim të rastit kur derivativi plotëson përkufizimin e një instrumenti kapitali në SNK 32.
 - (b) të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit që vijnë nga planet e përfitimit të punonjësve, për të cilat zbatohet SNK 19 *Përfitimet e Punonjësve*.
 - (c) kontratat për konsideratën e kushtëzuar në një kombinim biznesi (shih SNRF 3 *Kombinimi i Bizneseve*). Ky përjashtim zbatohet vetëm për njësinë blerëse.
 - (d) kontratat e sigurimit siç përcaktohen në SNRF 4 *Kontratat e Sigurimit*. Megjithatë ky SNRF zbatohet për derivativët që janë të përfshirë në kontratat e sigurimit nëse SNK 39 kërkon që njësia ekonomike duhet t'i trajtojë ato veçmas. Gjithashtu një emetues duhet të zbatojë SNRF për *kontratat e garancisë financiare* nëse emetuesi zbaton SNK 39 në njohjen dhe matjen e kontratave por duhet të zbatojë SNRF 4 nëse emetuesi zgjedh, në përputhje me paragrafin 4 (d) të SNRF 4, të zbatojë SNRF 4 në njohjen dhe matjen e tyre.
 - (e) instrumentat financiarë, kontratat dhe detyrimet nga transaksionet e pagesave të bazuara në aksione për të cilat zbatohet SNRF 2 *Pagesat e Bazuara në Aksione*, me përjashtim të rastit kur ky SNRF zbatohet për kontratat brenda objektit të paragrafëve 5-7 të SNK 39.
- 4 Ky SNRF zbatohet për instrumentat financiarë të njohur dhe të panjohur. Instrumentat financiarë të njohur përfshijnë aktive financiare dhe pasive financiare që janë objekt i SNK 39. Instrumentat financiarë të panjohur përfshijnë disa instrumenta financiarë që, megjithëse jashtë objektit të SNK 39, janë objekt i këtij SNRF (të tilla si disa angazhime huaje).
- 5 Ky SNRF zbatohet për kontratat për të blerë ose shitur një zë jo financiar që është objekt i SNK 39 (shih paragrafët 5-7 të SNK 39).

Klasat e instrumentave financiarë dhe niveli i dhënies së informacioneve shpjeguese

- 6 Nëse ky SNRF kërkon dhënie informacionesh shpjeguese sipas klasave të instrumentit financiar, një njësi ekonomike duhet të grupojë instrumentat financiarë në klasa që janë të përshtatshme me natyrën e informacionit të shpjeguar dhe duhet të marrë në konsideratë karakteristikat e këtyre instrumentave financiarë. Një njësi ekonomike duhet të japë informacion të mjaftueshëm që të lejojë rakordimin e nënzërave të paraqitur në bilancin kontabël.

Rëndësia e instrumentave financiarë për pozicionin financiar dhe performancën financiare

- 7 Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të saj të vlerësojnë rëndësinë e instrumentave financiarë për pozicionin e saj financiar dhe performancën e saj financiare.

Bilanci

Kategoritë e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare

- 8 Vlera kontabël e secilës prej kategorive vijuese, siç përcaktohet në SNK 39, duhet të paraqitet në bilanc ose në shënimet shpjeguese:
- aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke paraqitur veçmas (i) ato që janë të tilla nga njohja fillestare dhe (ii) ato që klasifikohen si të mbajtura për shitje në përputhje me SNK 39;
 - investimet e mbajtura deri në maturim;
 - huatë dhe të arkëtueshmet;
 - aktivet financiare gati për shitje;
 - pasivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke paraqitur veçmas (i) ato që janë të tilla nga njohja fillestare dhe (ii) ato që klasifikohen si të mbajtura për shitje në përputhje me SNK 39; dhe
 - pasivet financiare të matura me koston e amortizuar.

Aktivitet financiar ose pasivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

- 9 Nëse një njësi ekonomike ka përcaktuar një hua ose një të arkëtueshme (ose grupe huash ose të arkëtueshmesh) me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, duhet të japë informacione shpjeguese për:
- ekspozimin maksimal ndaj *riskut të kredisë* (shih paragrafin 36 (a)) të huasë ose të arkëtueshmes (ose grupit të huave ose të arkëtueshmeve) në datën e raportimit.
 - shumën me të cilën çdo derivativ kredije i lidhur ose instrumenta të ngjashëm zbusin këtë ekspozim maksimal ndaj riskut të kredisë.
 - shumën e ndryshimit, gjatë periudhës dhe shumën e akumuluar, me vlerën e drejtë të huasë ose të arkëtueshmes (ose grupit të huave ose të arkëtueshmeve) e cila i takon ndryshimit në riskun e kredisë së aktiveve financiare të përcaktuara ose:
 - si shumë e ndryshimit në vlerën e drejtë të saj e cila nuk i takon ndryshimeve në kushtet e tregut që sjellin *riskun e tregut*; ose
 - duke përdorur një metodë alternative, për të cilën njësi ekonomike beson se paraqet në mënyrë më besnike shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të saj (të huasë ose të arkëtueshmes) që i takon ndryshimeve në riskun e kredisë së aktivitetit.

Ndryshimet në kushtet e tregut të cilat sjellin riskun e tregut përfshijnë ndryshimet në një normë interesi të mbikqyrrur në çmimin e një malli, në kursin e këmbimit ose në indeksin e çmimeve.
 - shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të çdo derivativi kredije të lidhur ose instrumenti të ngjashëm që ka ndodhur gjatë periudhës dhe në mënyrë kumulative që prej momentit të përcaktimit të huasë ose të së arkëtueshmes.

- 10 Nëse një njësi ekonomike ka përcaktuar një pasiv financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes në përputhje me paragrafin 9 të SNK 39, duhet të japë informacione shpjeguese për:
- (a) shumën e ndryshimit, gjatë periudhës dhe shumën e akumuluar, në vlerën e drejtë të pasivit financiar që i takon ndryshimeve në riskun e kredisë së këtij pasivi të përcaktuar ose:
 - (i) si shumë e ndryshimit në vlerën e drejtë të tij që nuk i takon ndryshimeve në kushtet e tregut të cilat sjellin riskun e tregut (shih Shtojcën B, paragrafi B4); ose
 - (ii) duke përdorur një metodë alternative, për të cilën njësi ekonomike beson se paraqet në mënyrë më besnike shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të tij (të pasivit financiar) që i takon ndryshimeve në riskun e kredisë së pasivit.

Ndryshimet në kushtet e tregut të cilat sjellin riskun e tregut përfshijnë ndryshimet në një normë interesi standart, në çmimin e një instrumenti tjetër financiar të njësisë ekonomike, në çmimin e një malli, në kursin e këmbimit ose në indeksin e çmimeve ose normave. Për kontratat që përfshijnë një veti lidhëse, ndryshimet në kushtet e tregut përfshijnë ndryshimet në performancës e fondeve përkatëse të investimit të brendshme ose të jashtëme.
 - (b) diferencën mes vlerës kontabël të pasivit financiar dhe shumës që njësi ekonomike është e detyruar të paguajë në maturim mbajtësit të detyrimit sipas kontratës.
- 11 Njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për:
- (a) metodat e përdorura për të plotësuar kërkesat në paragrafët 9 (c) dhe 10 (a).
 - (b) nëse njësi ekonomike beson se dhënia e informacioneve shpjeguese për të plotësuar kërkesat në paragrafët 9(c) ose 10(a) nuk paraqet në mënyrë besnike ndryshimin në vlerën e drejtë të aktivitetit financiar ose pasivit financiar që i takon ndryshimeve në riskun e tij të kredisë, arsyet që sjellin këto përfundime dhe faktorët që ajo mendon se janë të rëndësishëm.

Riklasifikimi

- 12 Nëse njësi ekonomike ka riklasifikuar një aktiv financiar si një aktiv të matur:
- (a) me kosto ose koston e amortizuar, kundrejt vlerës së drejtë; ose
 - (b) me vlerën e drejtë, kundrejt koston ose koston së amortizuar;
- ajo duhet të japë informacione shpjeguese për shumën e riklasifikuar brenda dhe jashtë çdo kategorie dhe arsyet për këtë riklasifikim (shih paragrafët 51-54 të SNK 39).

Mosnjohja

- 13 Një njësi ekonomike mund të ketë transferuar aktive financiare në një mënyrë të tillë që pjesë ose të gjithë aktivet financiare nuk plotësojnë kërkesat (nuk kualifikohen) për mosnjohje (shih paragrafët 15-37 ose SNK 39). Njësi ekonomike, për secilën klasë të aktiveve financiare të tilla duhet të japë informacion shpjegues:
- (a) për natyrën e aktiveve;
 - (b) për natyrën e risqeve dhe përfitimeve nga pronësia e të cilave njësi ekonomike mbetet e ekspozuar;
 - (c) nëse njësi ekonomike vazhdon të njohë të gjitha aktivet, vlerat kontabël të aktiveve dhe pasiveve të lidhura; dhe
 - (d) nëse njësi ekonomike vazhdon të njohë aktivet, në madhësinë e përfshirjes së saj të vazhdueshme, shumën totale të vlerës kontabël të aktiveve fillestare, shumën e aktiveve që njësi ekonomike vazhdon të njohë dhe vlerën kontabël të pasiveve të lidhura.

Kolaterali

- 14 Njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për:
- (a) vlerën kontabël të aktiveve financiare të cilat i ka lënë peng si kolateral për pasive ose pasive të kushtëzuara përfshirë shumat që janë riklasifikuar në përputhje me paragrafin 37 (a) të SNK 39; dhe
 - (b) termat dhe kushtet e lidhura me lëniet e saj peng.
- 15 Nëse një njësi ekonomike mban një kolateral (të aktiveve financiare ose jo-financiare) dhe i lejohet ta shesë ose ta rivendosë kolateralin për llogari të saj në mungesë të një kundërshtimi nga pronari i kolateralit, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për:
- (a) vlerën e drejtë të kolateralit që mban;

- (b) vlerën e drejtë të çdo kolaterali të tillë të shitur ose të rivendosur si garanci dhe nëse njësia ekonomike ka një detyrim ta kthejë atë; dhe
- (c) termat dhe kushtet që lidhen me përdorimet që ajo i bën kolateralit.

Llogaria zbritje për humbjet nga kreditimi

- 16 Nëse aktivet financiare zhvlerësohen nga një humbje kreditimi dhe njësia ekonomike regjistron zhvlerësimin në një llogari të veçantë (p.sh. një llogari zbritje e përdorur për të regjistruar zhvlerësimet individuale ose një llogari e ngjashme e përdorur për të regjistruar një zhvlerësim kolektiv të aktiveve) në vend të një pakësimi të drejtpërdrejtë të vlerës kontabël të aktivit, ajo duhet të japë si informacion shpjegues një rakordim të ndryshimeve në atë llogari gjatë periudhës për secilën klasë të aktiveve financiare.

Instrumentat financiarë të përbërë me derivativë të shumfishtë të përfshirë

- 17 Nëse një njësi ekonomike ka nxjerrë një instrument i cili përmban si një përbërës pasivi edhe një përbërës kapitali (shih paragrafin 28 të SNK 32) dhe nëse instrumenti ka derivativë të shumfishtë të përfshirë vlerat e të cilëve janë të ndërvarura (të tilla si një instrument borxhi i konvertueshëm dhe i kërkueshëm), ajo duhet të japë informacion shpjegues lidhur me ekzistencën e këtyre karakteristikave.

Mospagimet dhe shkeljet

- 18 Për *huatë e pagueshme* të njohura në datën e raportimit, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues:
- (a) lidhur me hollësitë e çdo mospagimi gjatë periudhës të principalit, të interesit, të fondit të akumuluar për pagesën e huave, ose të termave të dëmshpërblimit për këto hua të pagueshme;
 - (b) për vlerën kontabël të huave të pagueshme ende të papaguara në datën e raportimit; dhe
 - (c) nëse mospagimi u sistemua, ose nëse termat e huasë së pagueshme u rinegociuan, përpara se pasqyrat financiare të miratoheshin për publikim.
- 19 Nëse gjatë periudhës, ndodhën shkelje të termave të marrëveshjes së huasë përveç atyre të të përshkruar në paragrafin 18, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues të njëjtë me atë të kërkuar në paragrafin 18 nëse këto shkelje lejuan huadhënësin të kërkojë shlyerjen (ripagimin) e përshtjetuar (me përjashtim të rastit kur shkeljet u sistemuan ose termat e huasë u rinegociuan në ose para datës së raportimit).

Pasqyra e të ardhurave dhe kapitali

Zëra të të ardhurave, shpenzimeve, fitimeve ose humbjeve

- 20 Në pasqyrat financiare ose në shënimet shpjeguese, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për zërat në vijim të të ardhurave, shpenzimeve, fitimeve ose humbjeve:
- (a) fitimet neto ose humbjet neto të:
 - (i) aktiveve financiare ose pasiveve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke paraqitur veçmas ato që vijnë nga aktive financiare ose pasive financiare të përcaktuara si të tilla nga njohja fillestare dhe ato që vijnë nga aktive financiare ose pasive financiare që klasifikohen si të mbajtura për shitje në përputhje me SNK 39;
 - (ii) aktiveve financiare të mbajtura për shitje, duke treguar veçmas shumën e fitimit ose të humbjes së njohur drejtpërdrejt në kapital gjatë periudhës dhe shumën e hequr nga kapitali dhe të njohur në fitimin ose humbjen e periudhës;
 - (iii) investimet e mbajtura deri në maturim;
 - (iv) huatë dhe të arkëtueshmet; dhe
 - (v) pasivet financiare të matura me koston e amortizuar.
 - (b) të ardhurat gjithsej nga interesi dhe shpenzimet gjithsej nga interesi (të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv) për aktivet financiare ose pasivet financiare që nuk janë me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes;
 - (c) të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet (të ndryshme nga shumat e përfshira në përcaktimin e normës efektive të interesit) që vijnë nga:

- (i) aktivet financiare ose pasivet financiare të cilat nuk janë me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes; dhe
 - (ii) aktivitetet trust dhe veprimtari besimi që vijnë nga mbajtja ose investimi i aktiveve për llogari të tretëve, trusteve, planeve të përfitimit të pensionit dhe institucioneve të tjera.
- (d) të ardhurat nga interesi i aktiveve financiare të zhvlerësuara të konstatuara në përputhje me paragrafin AG93 të SNK 39; dhe
- (e) shumën e çdo humbjeje nga zhvlerësimi për secilën klasë të aktiveve financiare.

Informacione shpjeguese të tjera

Politikat kontabël

- 21 Në përputhje me paragrafin 108 të SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* një njësi ekonomike jep informacion shpjegues, në përmbledhjen e politikave kryesore kontabël, për bazën (ose bazat) e matjes të përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe politika të tjera kontabël që janë të rëndësishme për kuptimin e pasqyrave financiare.

Kontabiliteti i mbrojtjes

- 22 Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues veçmas për çdo tip të mbrojtjes të përshkruar në SNK 39 (p.sh. mbrojtjet me vlerën e drejtë, mbrojtjet e fluksit monetar dhe mbrojtjet e investimev neto në operacionet e huaja) si vijon:
- (a) një përshkrim për çdo tip mbrojtjeje;
 - (b) një përshkrim për instrumentat financiarë të përcaktuar si instrumenta mbrojtës dhe vlerën e drejtë të tyre në datën e raportimit; dhe
 - (c) natyrën e risqeve nga të cilat mbrohemi.
- 23 Lidhur me mbrojtjen e fluksit monetar një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues:
- (a) për periudhat gjatë të cilave pritet që të ndodhin flukset monetare dhe kur pritet që ato të ndikojnë fitimin ose humbjen;
 - (b) një përshkrim i çdo transaksioni parashikues për të cilin kontabiliteti mbrojtës është përdorur më parë por që nuk pritet të ndodhë përsëri;
 - (c) shumën që është njohur në kapital gjatë periudhës;
 - (d) shumën që u hoq nga kapitali dhe u përfshi në fitimin ose humbjen e periudhës duke treguar shumën e përfshirë në secilin zë të pasqyrës së të ardhurave; dhe
 - (e) shumën që u hoq nga kapitali gjatë periudhës dhe u përfshi në koston fillestare ose në vlerën kontabël të ndonjë aktivi tjetër jo-financiar ose pasivi jo financiar, blerja e të cilëve ose ndodhja ishte një transaksion mbrojtës parashikues me probabilitet të lartë.
- 24 Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues veçmas për:
- (a) mbrojtjet me vlerën e drejtë, fitimet ose humbjet:
 - (i) të instrumentin mbrojtës; dhe
 - (ii) në zërin e mbrojtur që i takon riskut të mbrojtur.
 - (b) mosefikasitetin e njohur në fitimin ose humbjen që vjen nga mbrojtjet e fluksit monetar; dhe
 - (c) Inefektivitetin e njohur në fitimin ose humbjen që vjen nga mbrojtjet e investimeve neto në operacionet e huaja;

Vlera e drejtë

- 25 Me përjashtim të rastit të paraqitur në paragrafin 29, për secilën klasë të aktive financiare dhe pasiveve financiare (shih paragrafin 6), një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për vlerën e drejtë të asaj klase të aktiveve dhe pasiveve në një mënyrë që lejon të bëhen krahasime me vlerën e saj kontabël.
- 26 Në dhënien e informacioneve shpjeguese për vlerën e drejtë, një njësi ekonomike duhet të grupojë aktivet financiare dhe pasivet financiare në klasa, por duhet të kompensojë ato vetëm në masën që janë kompensuar në bilancin kontabël vlerat kontabël të tyre

- 27 Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese:
- metodat dhe, nëse është përdorur një teknikë vlerësimi, supozimet e zbatuara në përcaktimin e vlerës së drejtë për secilën klasë të aktiveve financiare ose pasiveve financiare. Për shembull, nëse është e zbatueshme, një njësi ekonomike jep informacion shpjegues rreth supozimeve të lidhura me normat e parapagimeve, normat e humbjeve të vlerësuar të kredisë dhe normat e interesit ose normat e skontimit.
 - nëse vlerat e drejta janë përcaktuar, plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë duke ju referuar kuotimeve të publikuara të çmimit në një treg aktiv ose janë vlerësuar duke përdorur një teknikë vlerësimi (shih paragrafët AG71-AG79 të SNK 39).
 - nëse vlerat e drejta të njohura ose të paraqitura në pasqyrat financiare janë përcaktuar plotësisht ose pjesërisht duke përdorur një teknikë vlerësimi të bazuar në supozime të cilat nuk mbështeten nga çmimet e transaksioneve të vrojtuar në tregun aktual të të njëjtit instrument (p.sh. pa modifikime apo rigrupime) dhe që nuk janë të bazuara në të dhënat e disponueshme dhe të vrojtueshme të tregut. Për vlerat e drejta të njohura në pasqyrat financiare, nëse ndryshimi i një ose më shumë prej këtyre supozimeve në supozime alternative të mundshme të arsyeshme, do të ndryshonte ndjeshëm vlerën e drejtë, njësi ekonomike duhet të theksojë këtë fakt dhe të japë informacion shpjegues për efektin e këtyre ndryshimeve. Për këtë qëllim, rëndësia duhet të gjykohet duke u mbështetur në fitimin ose humbjen dhe aktivet gjithsej ose pasivet gjithsej ose kur ndryshimet në vlerën e drejtë janë njohur në kapital, në kapitalin gjithsej.
 - nëse zbatohet pika (c), shumën totale të ndryshimit në vlerën e drejtë të vlerësuar duke përdorur një teknikë të tillë vlerësimi që është njohur në fitimin ose humbjen gjatë periudhës.
- 28 Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, një njësi ekonomike përcakton vlerën e drejtë të tij duke përdorur një teknikë vlerësimi (shih paragrafët AG74-AG79 të SNK 39). Megjithatë evidenca më e mirë e vlerës së drejtë në njohjen fillestare është çmimi i transaksionit (p.sh. vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë), me përjashtim të rastit kur plotësohen kushtet e përshkruara në paragrafin AG76 të SNK 39. Si pasojë mund të ketë një diferencë (ndryshim) mes vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe shumës që do të përcaktohet në po atë datë duke përdorur teknikën e vlerësimit. Nëse ekziston një diferencë e tillë, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues, për çdo klasë instrumentit financiar:
- për politikën kontabël të saj për njohjen e kësaj difference në fitimin ose humbjen për të pasqyruar një ndryshim në faktorët (përfshirë kohën) që pjesëmarrësit në treg do të marrin në konsideratë në vendosjen e një çmimi (shih paragrafin AG76A të SNK39); dhe
 - për diferencën gjithsej të mbetur për t'u njohur në fitimin ose humbjen në fillim dhe në fund të periudhës dhe një rakordim të ndryshimeve në balancë të kësaj difference.
- 29 Nuk kërkohet dhënie e informacioneve shpjeguese për vlerën e drejtë:
- nëse vlera kontabël është me përafërsi të arsyeshme vlera e drejtë, për shembull, për instrumentat financiarë si të arkëtueshmet dhe të pagueshmet afatshkurtra tregtare;
 - për një investim në instrumenta kapitali të cilat nuk kanë një çmim tregu të kuotuar në një treg aktiv, ose derivativë të lidhur me instrumenta të tillë kapitali, të cilat maten me kosto në përputhje me SNK 39 sepse vlera e drejtë e tij nuk mund të matet në mënyrë të besueshme; ose
 - për një kontratë që përmban një karakteristikë të pjesëmarrjes së lirë për të vepruar (siç përshkruhet në SNRF 4) nëse vlera e drejtë e kësaj karakteristike nuk mund të matet në mënyrë të besueshme.
- 30 Në rastet e përshkruara në paragrafin 29(b) dhe (c), një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për të ndihmuar përdoruesit e pasqyrave financiare që të bëjnë gjykimet e tyre lidhur me madhësinë e ndryshimeve të mundshme mes vlerës kontabël të këtyre aktiveve financiare ose pasiveve financiare dhe vlerës së drejtë të tyre, duke përfshirë:
- faktin se informacioni për vlerën e drejtë nuk është paraqitur për këto instrumenta sepse vlera e drejtë e tyre nuk mund të matet në mënyrë të besueshme;
 - një përshkrim të instrumentave financiarë, vlerës kontabile të tyre dhe një shpjegim pse vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme;
 - informacion lidhur me tregun për instrumentat;
 - informacion për kur dhe si njësi ekonomike priret të japë informacione shpjeguese për instrumentat financiarë; dhe
 - nëse instrumentat financiarë, vlera e drejtë e të cilëve më parë nuk mund të matej në mënyrë të besueshme janë çregjistruar (mosnjohur), këtë fakt, vlerën kontabël të tyre në kohën e çregjstrimit dhe shumën e fitimit ose humbjes së njohur.

Natyrë dhe madhësia e risqeve (rreziqeve) që vijnë nga instrumentat financiarë

- 31 Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë natyrën dhe madhësinë e risqeve që vijnë nga instrumentat financiarë ndaj të cilëve është ekspozuar njësi ekonomike në datën e raportimit.
- 32 Informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 33-42 përqendrohen në risqet që vijnë nga instrumentat financiarë dhe sesi janë manaxhuar ato. Zakonisht këto risqe përfshijnë, por nuk kufizohen në, riskun e kredisë, *riskun e likuiditetit* dhe riskun e tregut.

Dhënie informacionesh shpjeguese cilësore

- 33 Për çdo tip risku që vjen nga instrumentat financiarë, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për:
- (a) ekspozimin ndaj riskut dhe sesi vjen ai;
 - (b) objektivat, politikat dhe proceset e saj për manaxhimin e riskut dhe metodat e përdorura për të matur riskun; dhe
 - (c) çdo ndryshim në pikat (a) dhe (b) nga periudha e mëparshme.

Dhënie informacionesh shpjeguese sasiore

- 34 Për çdo tip risku që vjen nga instrumentat financiarë, një njësi ekonomike duhet të paraqesë:
- (a) një përmbledhje të dhënash sasiore rreth ekspozimit të saj ndaj riskut në datën e raportimit. Kjo dhënie informacionesh shpjeguese duhet të bazohet në informacionin e siguruar brenda njësisë ekonomike nga personeli kryesor drejtues (siç përcaktohet në SNK 24 *Palët e Lidhura-Dhënie Informacionesh Shpjeguese*), për shembull bordi drejtues i njësisë ekonomike ose drejtori ekzekutiv i saj.
 - (b) dhënie informacionesh shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 36-42, në madhësinë jo të siguruar në pikën (a), me përjashtim të rastit kur risku nuk është material (shih paragrafët 29-31 të SNK 1 për diskutimin e materialitetit).
 - (c) përqendrimet e riskut nëse nuk janë të dukshme nga pikat (a) dhe (b).
- 35 Nëse të dhënat sasiore të paraqitura në datën e raportimit nuk janë përfaqësuese për ekspozimin ndaj riskut të njësisë ekonomike gjatë periudhës, njësi ekonomike duhet të japë informacion tjetër që është përfaqësues.

Risku i kredisë

- 36 Njësi ekonomike duhet të shpjegojë, për çdo klasë instrumenti financiar:
- (a) shumën që përfaqëson më mirë ekspozimin e saj maksimal ndaj riskut të kredisë në datën e raportimit pa marrë parasysh kolateralët e mbajtur ose zgjerime të tjera të kredisë (p.sh. marrëveshje kompensimi të brendshme (neto) të cilat nuk kualifikohen për kompensim në përputhje me SNK 32);
 - (b) në lidhje me shumën e paraqitur në pikën (a) një përshkrim të kolateralit të mbajtur si garanci dhe shtesave (zgjerimeve) të tjera të kredisë;
 - (c) informacionin lidhur me cilësinë e kredisë së aktiveve financiare që *nuk janë për t'u shlyer* dhe as të zhvlerësuar; dhe
 - (d) vlerën kontabël të aktiveve financiare që do të ishte ndryshe për t'u shlyer ose e zhvlerësuar, termat e së cilës janë rinegociuar.

Aktivet financiare për t'u shlyer ose të zhvlerësuar

- 37 Njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues, për çdo klasë instrumenti financiar:
- (a) një analizë të jetëgjatësisë (moshës) të aktiveve financiare që janë për t'u shlyer në datën e raportimit por jo të zhvlerësuar;
 - (b) një analizë të aktiveve financiare që janë përcaktuar individualisht për tu zhvlerësuar në datën e raportimit përfshirë faktorët që njësi ekonomike merr në konsideratë për t'i zhvlerësuar ato; dhe

- (c) për shumat e paraqitura në pikat (a) dhe (b), një përshkrim të kolateralit të mbajtur nga njësia ekonomike si letër me vlerë dhe shtesa të tjera të kredisë dhe, një vlerësim të vlerës së drejtë të tyre, me përjashtim të rastit kur nuk është e zbatueshme.

Kolaterali dhe të tjera aktive që mbahen si garanci kredie

- 38 Nëse një njësi ekonomike merr aktive financiare ose jo-financiare gjatë periudhës duke marrë në zotërim kolateralin që mban si letër me vlerë ose duke kërkuar shtesa të tjera kredije (p.sh. garancitë) dhe aktive të tilla plotësojnë kushtin e njohjes në Standardet e tjera, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues:
- (a) për natyrën dhe vlerën kontabël të aktiveve të marra; dhe
- (b) nëse aktivet nuk janë lehtësisht të konvertueshme në mjete monetare, politikat e saj për tërheqjen e aktiveve të tilla ose për përdorimin e tyre në operacionet e saj.

Risku i likuiditetit

- 39 Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për:
- (a) analizën e maturimit për pasivet financiare e cila tregon maturimet e mbetura sipas kontratës; dhe
- (b) një përshkrim sesi ajo manaxhon riskun e likuiditetit të pranishëm në pikën (a).

Risku i tregut

Analiza e ndjeshmërisë

- 40 Me përjashtim të rastit kur njësia ekonomike plotëson kërkesat e paragrafit 41, ajo duhet të japë informacion shpjegues:
- (a) një analizë ndjeshmërie për çdo lloj risku të tregut ndaj të cilit njësia ekonomike është e ekspozuar në datën e raportimit, duke treguar sesi fitimi ose humbja dhe kapitali janë ndikuar nga ndryshimet në variablat e rëndësishëm të riskut që ishin me probabilitet të lartë ndodhjeje në atë datë;
- (b) metodat dhe supozimet e përdorura në përgatitjen e analizës së ndjeshmërisë; dhe
- (c) ndryshimet nga periudha e mëparëshme në metodat dhe supozimet e përdorura dhe arsyet për këto ndryshime.
- 41 Nëse një njësi ekonomike përgatit një analizë ndjeshmërie, të tillë si vlerë e rrezikuar, që pasqyron ndërvlerësitë mes variablave të riskut (p.sh. normave të interesit dhe kurseve të këmbimit) dhe e përdor atë për të manaxhuar risqet financiare, ajo mund të përdorë atë analizë të ndjeshmërisë në vend të analizës të cilësuar në paragrafin 40. Njësia ekonomike duhet të paraqesë gjithashtu:
- (a) një shpjegim të metodës së përdorur në përgatitjen e një analize të tillë ndjeshmërie dhe të parametrave kryesorë dhe të supozimeve të bëra për të dhënat e siguruar; dhe
- (b) një shpjegim të objektivit të metodës së përdorur dhe të kufizimeve që mund të çojnë në informacion që nuk pasqyron plotësisht vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të përfshira.

Dhënie të tjera informacionesh shpjeguese të riskut të tregut

- 42 Në rast se analizat e ndjeshmërisë të paraqitura në përputhje me paragrafin 40 ose 41 nuk janë përfaqësuese të një risku të pranishëm në një instrument financiar (për shembull sepse ekspozimi i fund-vitit nuk pasqyron ekspozimin gjatë vitit) njësia duhet të paraqesë këtë fakt dhe arsyen pse ajo beson se analizat e ndjeshmërisë nuk janë përfaqësuese.

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

- 43 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë SNRF për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi i më hershëm i tij. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë SNRF për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 44 Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë SNRF për periudha vjetore që fillojnë më parë se 1 Janar 2006, nuk ka nevojë që ajo të paraqesë informacion krahasues për dhënen e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 31-42 rreth natyrës dhe madhësisë së risqeve që vijnë nga instrumentat financiarë.

Tërheqja e SNK 30

- 45 Ky SNRF zëvendëson SNK30 *Dhënie Informacionesh Shpjeguese në Pasqyrat Financiare të Bankave dhe Institucioneve Financiare të Ngjashme*

Shotjçë A

Termt e përcaktuar

Kjo shtojçë është pjesë përbërëse e SNRF.

| | |
|--|---|
| Risku i kredisë | Risku që një palë në një instrument financiar do të shkaktojë humbje financiare për palën tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi. |
| risku i monedhës | Risku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit. |
| risku i normave të interesit | Risku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. |
| Risku i likuiditetit | Risku që një njësi ekonomike do të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të lidhura me pasivet financiare. |
| huatë e pagueshme | Huatë e pagueshme janë pasive financiare, të ndryshme nga të pagueshmet tregtare afatshkurtra në termt normale (të zakonshme) të kredisë. |
| Risku i tregut | Risku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Risku i tregut përfshin tre tipe risqesh: riskun e monedhës, riskun e normave të interesit dhe riskun tjetër të çmimit. |
| risku tjetër i çmimit | Risku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të instrumentave financiarë do të ndryshojnë për shkak të ndryshimit të çmimeve në treg (të tjera nga ato që vijnë nga risku i normës së interesit ose risku i monedhës) pavarësisht nëse këto ndryshime janë shkaktuar nga faktorë specifik për instrumentin financiar individual ose emetuesin e tij ose faktorë që ndikojnë të gjithë instrumentat financiarë të ngjashëm të tregtuar në treg. |
| për t'u shlyer se i ka kaluar afati | Një aktiv financiar është për t'u shlyer nëse një kundërpalë ka dështuar në bërjen e një pagese të kërkuar sipas kontratës. |

Termt në vijim janë përkufizuar në paragrafin 11 të SNK 32 ose në paragrafin 9 të SNK 39 dhe përdoren në SNRF me kuptimin e specifikuar në SNK 32 dhe SNK 39.

- kosto e amortizuar e një aktivi financiar ose pasivi financiar
- aktive financiare gati për shitje;
- mosnjohja
- derivativ
- metoda e interesit efektiv
- instrument kapitali (neto)
- vlera e drejtë
- aktiv financiar
- instrument financiar
- pasiv financiar
- aktiv financiar ose pasiv financiar me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes
- kontratë e garancisë financiare
- aktiv financiar ose pasiv financiar i mbajtur për tregtim
- transaksion parashikues
- instrument mbrojtës
- investime të mbajtura deri në maturim

- huatë dhe të arkëtueshmet
- blerje ose shitje në mënyrë të rregullt

Shtojcë B

Udhëzues zbatimi

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF.

Klasat e instrumentave financiarë dhe niveli i dhënies së informacioneve shpjeguese (paragrafi 6)

- B1 Paragrafi 6 i kërkon një njësi ekonomike të grupojë instrumentat financiarë në klasa që janë të përshtatshme me natyrën e informacionit të paraqitur dhe që merr në konsideratë karakteristikat e këtyre instrumentave financiarë. Klasat e përshkruara në paragrafin 6 përcaktohen nga njësi ekonomike dhe prandaj janë të dallueshme nga kategoritë e instrumentave financiarë të specifikuar në SNK 39 (i cili përcakton sesi maten instrumentat financiarë dhe kur njihen ndryshimet në vlerën e drejtë).
- B2 Në përcaktimin e klasës së instrumentit financiar, një njësi ekonomike duhet që të paktën:
- (a) të dallojë instrumentat e matur me koston e amortizuar nga ata të matur me vlerën e drejtë.
 - (b) të trajtojë si një klasë të veçantë ose klasa të veçanta ato instrumenta financiarë që janë jashtë objektit të këtij SNRF.
- B3 Një njësi ekonomike vendos, në varësi të rrethanave të saj, sa hollësira (detaje) të paraqesë për të plotësuar kërkesat e këtij SNRF, sesa rëndësi duhet t'u japë aspekteve të ndryshme të kërkesave dhe sesi të bashkojë informacionin për të paraqitur një pamje të plotë pa kombinuar informacione me karakteristika të ndryshme. Është e nevojshme të gjendet një e mesme mes mbingarkimit të pasqyrave financiare me detaje (hollësi) të tepërta të cilat mund të mos u shërbejnë përdoruesve të pasqyrave financiare dhe fshehjes së informacionit të rëndësishëm si rezultat i bashkimit (agregimit) të tepërt. Për shembull, një njësi ekonomike nuk duhet të fshehë informacion të rëndësishëm duke e përfshirë atë mes shumë detajeve (hollësive) të parëndësishme. Në mënyrë të ngjashme, një njësi ekonomike nuk duhet të japë informacion shpjegues që është kaq i bashkuar (grupuar) sa që fsheh ndryshimet e rëndësishme mes transaksioneve individuale ose risqeve të lidhura me to.

Rëndësia e instrumentave financiarë për pozicionin financiar dhe performancën financiare

Pasivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (paragrafët 10 dhe 11)

- B4 Nëse një njësi ekonomike përcakton një pasiv financiar me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, paragrafi 10(a) kërkon që ajo të paraqesë shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të pasivit financiar që i takon ndryshimeve në riskun e kredisë së pasivit. Paragrafi 10(a)(i) lejon një njësi ekonomike të përcaktojë këtë shumë si shumë e ndryshimit në vlerën e drejtë të pasivit që nuk i takon ndryshimeve në kushtet e tregut të cilat sjellin riskun e tregut. Nëse ndryshimet e vetme të rëndësishme në kushtet e tregut për një pasiv janë ndryshimet në një normë interesi të mbikëqyrtur, kjo shumë mund të vlerësohet si vijon:
- (a) Së pari, një njësi ekonomike llogarit normën e brendshme të kthimit të pasivit në fillim të periudhës duke përdorur çmimin e vrojtuar të tregut për pasivin dhe fluksin monetar të pasivit sipas kontratës në fillim të periudhës. Zbritet nga kjo normë kthimi norma e interesit të mbikëqyrtur në fillim të periudhës, për të përcaktuar për një instrument, përbërësin specifik të normës së brendshme të kthimit.
 - (b) Më pas njësi ekonomike llogarit vlerën aktuale të fluksit monetar të lidhur me pasivin duke përdorur fluksin monetar sipas kontratës të pasivit në fund të periudhës dhe një normë skontimi të barabartë me shumën e (i) normës së interesit të mbikëqyrtur në fund të periudhës dhe (ii) përbërësin specifik për instrumentin të normës së brendshme të kthimit të përcaktuar në pikën (a).
 - (c) Ndryshimi mes çmimit të vrojtuar të tregut të pasivit në fund të periudhës dhe shumës së përcaktuar në pikën (b) është ndryshimi në vlerën e drejtë që nuk i takon ndryshimeve në normën e interesit të mbikëqyrtur. Kjo është shuma që duhet të paraqitet.

Ky shembull supozon se ndryshimet në vlerën e drejtë që vijnë nga faktorë të ndryshëm nga ndryshimet në riskun e kredisë së instrumentit ose ndryshimet në normat e interesit nuk janë të rëndësishme. Nëse instrumenti

në shembull përmban një derivativ të përfshirë, ndryshimi në vlerën e drejtë të derivativit të përfshirë përjashtohet (nuk merret parasysh) në përcaktimin e shumës për t'u përfshirë në përputhje me paragrafin 10(a).

Dhënie informacionesh të tjera shpjeguese – politikat kontabël (paragrafi 21)

- B5 Paragrafi 21 kërkon dhënie informacionesh shpjeguese për bazën (ose bazat) e matjes së përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe politikave kontabël të tjera të përdorura të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar pasqyrat financiare. Për instrumentat financiarë, dhënie informacionesh shpjeguese të tilla mund të përfshijnë:
- (a) për aktivet financiare ose pasivet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes:
 - (i) natyrën e aktiveve financiare ose pasiveve financiare të cilat njësia ekonomike i ka përcaktuar me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes;
 - (ii) kriterin për një përcaktim të tillë të këtyre aktiveve financiare ose pasiveve financiare në njohjen fillestare; dhe
 - (iii) sesi njësia ekonomike ka plotësuar kushtet e paragrafit 9, 11A ose 12 të SNK 39 për këtë përcaktim. Për instrumentat e përcaktuar në përputhje me paragrafin (b)(i) të përkufizimit të një aktivi financiar ose pasivi financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në SNK 39, kjo paraqitje përfshin një përshkrim tregues të rrethanave duke theksuar paqendrueshmërinë e matjes ose të njohjes që përndryshe do të mund të shfaqej. Për instrumentat e përcaktuar në përputhje me paragrafin (b)(ii) të përkufizimit të një aktivi financiar ose pasivi financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në SNK 39, kjo paraqitje përfshin një përshkrim tregues sesi përcaktimi me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes është i qendrueshëm me manaxhimin e riskut ose strategjinë e investimit të dokumentuar të njësisë ekonomike.
 - (b) kriterin për përcaktimin e aktiveve financiare si të vlefshme për shitje.
 - (c) nëse blerjet dhe shitjet në mënyrë të rregullt të aktiveve financiare janë kontabilizuar në datën e tregtimit ose të shlyerjes (shih paragrafin 38 të SNK 39).
 - (d) nëse një llogari zbritjeje përdoret për të zvogëluar vlerën kontabël të aktiveve financiare të zhvlerësuar nga humbjet e kreditimit:
 - (i) kriterin për përcaktimin nëse vlera kontabël e aktiveve financiare të zhvlerësuar është zvogëluar drejtpërsëdrejti (ose në rastin e një rimarrje të zhvlerësimit, është rritur drejtpërsëdrejti) dhe nëse është përdorur llogaria e zbritjes; dhe
 - (ii) kriterin për anulimin e shumave të regjistruara në llogarinë e zbritjeve kundrejt vlerës kontabël të aktiveve të zhvlerësuar (shih paragrafin 16).
 - (e) si përcaktohen fitimet ose humbjet neto në secilën kategori të instrumentit financiar (shih paragrafin 20 (a)) për shembull, nëse fitimet ose humbjet neto në zërat me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes përfshijnë të ardhurat nga interesat ose dividendët.
 - (f) kriterin që përdor njësia ekonomike për të përcaktuar se ka një evidencë të mjaftueshme që ka ndodhur një humbje nga zhvlerësimi (shih paragrafin 20(e)).
 - (g) nëse termat e aktiveve financiare të cilët ndryshe do të ishin të kërkuar për t'u paguar ose të zhvlerësuar janë rinegociuar, politikën kontabël për aktivet financiare që janë subjekt i termave të rinegociuar (shih paragrafin 36(d)).

Paragrafi 113 i SNK 1 kërkon gjithashtu që njësitë ekonomike të japin informacion shpjegues, në përmbledhje të politikave kontabël të rëndësishme ose në shënimet e tjera, lidhur me gjykimet, përveç atyre që përfshijnë vlerësimet, që ka bërë drejtimi në procesin e zbatimit të politikave kontabël të njësisë ekonomike dhe që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare.

Natyrë dhe madhësia e risqeve (rreziqeve) që vijnë nga instrumentat financiarë (paragrafët 31-42)

- B6 Dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 31-42 duhet të jepet ose në pasqyrat financiare ose të përfshihet nëpërmjet referencës së kryqëzuar me pasqyrat financiare në pasqyra të tjera, të tilla si komentet e manaxhimit ose raportin e riskut, që janë të disponueshme për përdoruesit e pasqyrave financiare në të njëjtat

terma si pasqyrat financiare dhe në të njëjtën kohë. Pa informacionin e përfshirë përmes referencës së kryqëzuar, pasqyrat financiare nuk janë të plota.

Dhënie informacionesh shpjeguese sasiore (paragrafi 34)

- B7 Paragrafi 34 (a) kërkon paraqitjen e të dhënave sasiore të përmbledhura lidhur me ekspozimin e një njësie ekonomike ndaj risqeve të bazuar në informacionin e siguruar nga brenda njësisë ekonomike nga personeli kyç drejtues. Nëse një njësi ekonomike përdor disa metoda për të manaxhuar një ekspozim ndaj riskut, njësia ekonomike duhet të paraqesë informacion duke përdorur metodën ose metodat që sigurojnë informacionin më të rëndësishëm dhe më të besueshëm. SNK 8 *Politikat Kontabile, Ndryshimet në Vlerësimet dhe Gabimet* trajton rëndësinë dhe besueshmërinë.
- B8 Paragrafi 34(c) kërkon dhënie informacionesh shpjeguese rreth përqendrimeve të riskut. Përqendrimet e riskut vijnë nga instrumenta financiarë që kanë karakteristika të ngjashme dhe ndikohen në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në kushtet ekonomike ose të tjera kushte. Identifikimi i përqendrimeve të riskut kërkon gjykim, duke marrë në konsideratë rrethanat e njësisë ekonomike. Dhënia e informacioneve shpjeguese lidhur me përqendrimet e riskut duhet të përfshijë:
- një përshkrim sesi drejtimi përcakton përqendrimet;
 - një përshkrim të karakteristikave të përbashkëta që identifikojnë çdo përqendim (p.sh. palën tjetër, zonën gjeografike, monedhën ose tregun); dhe
 - shumën e ekspozimit ndaj riskut të lidhur me gjithë instrumentat financiarë që kanë këtë karakteristikë të përbashkët.

Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë (paragrafi 36(a))

- B9 Paragrafi 36(a) kërkon paraqitjen e shumës që përfaqson më mirë ekspozimin maksimal të njësisë ekonomike ndaj riskut të kredisë. Për një aktiv financiar, zakonisht kjo është vlera kontabël bruto, e pakësuar për:
- çdo shumë të kompensuar në përputhje me SNK 32; dhe
 - çdo humbje nga zhvlerësimi të njohur në përputhje me SNK 39.
- B10 Aktivitetet që sjellin riskun e kredisë dhe ekspozimin maksimal që shoqëron riskun e kredisë, përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në:
- dhënia me interes shume te ulet e huave ose të arkëtueshmeve klientëve dhe vendosja e depozitave me njësi të tjera ekonomike. Në raste të tilla ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë është vlera kontabël e aktiveve financiare përkatëse.
 - lidhja e kontratave për derivativë, p.sh. kontrata të këmbimeve të huaja, të normave të interesit sëap dhe të derivativëve të kredisë. Nëse aktivi që rezulton matet me vlerën e drejtë, ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë në datën e raportimit do të jetë i barabartë me vlerën kontabël.
 - dhënen e garancive financiare. Në këtë rast, ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë është shuma maksimale që njësia ekonomike do të mund të paguante nëse garancia kërkohet, e cila mund të jetë shumë më e madhe se shuma e njohur si një pasiv.
 - marrja e një angazhimi huaje të pakthyesëm për gjatë jetës së mjetit ose që është i kthyeshëm vetëm në këmbim të një ndryshimi material negativ. Nëse emetuesi nuk mund të krijojë një angazhim huaje neto në mjete monetare ose në një instrument financiar tjetër, ekspozimi maksimal i kredisë është shuma e plotë e angazhimit. Kjo sepse është e pasigurt nëse shuma e çdo pjese të patërheqshme mund të jetë e tërheqshme në të ardhmen. Kjo mund të jetë shumë më e madhe sesa shuma e njohur si pasiv.

Analiza kontraktuale (sipas kontratës) e maturimit (paragrafi 39(a))

- B11 Gjatë përgatitjes së analizës kontraktuale të maturimit për pasivet financiare, të kërkuar nga paragrafi 39(a), një njësi ekonomike përdor gjykimin e saj për të përcaktuar numrin e përshtatshëm të brezave (hapësirës) kohore. Për shembull, një njësi ekonomike mund të përcaktojë se brezat (hapësirat) kohore vijuese janë të përshtatshme:
- jo me vonë se një muaj;
 - më vonë se një muaj dhe jo më vonë se tre muaj;
 - më vonë se tre muaj dhe jo më vonë se një vit; dhe
 - më vonë se një vit dhe jo më vonë se pesë vjet.

- B12 Nëse pala tjetër ka mundësi zgjedhjeje se kur duhet të paguhet një shumë, pasivi përfshihet në bazë të datës më të hershme në të cilën njësisë ekonomike mund t'i kërkohej të paguajë. Për shembull, pasivet financiare që një njësi ekonomike mund t'i kërkohej t'i shlyejë sipas kërkesës (p.sh. depozitat në të parë) përfshihen në hapësirën kohore më të hershme.
- B13 Nëse një njësi ekonomike angazhohet të bëjë të disponueshme shumat me këste, çdo këst shpërndahet në periudhën më të hershme për të cilën njësisë ekonomike i kërkohej të paguajë. Për shembull, një angazhim i patërheqshëm huaje përfshihet në hapësirën kohore që përmban datën më të hershme në të cilën mund të tërhiqet (huaja).
- B14 Shumat e paraqitura në analizën e maturimit janë flukset monetare të pa skontuara sipas kontratës, për shembull:
- (a) detyrimet bruto të qirasë financiare (para zbritjes së komisioneve të financimit);
 - (b) çmimet e specifikuara në marrëveshjet e së ardhmes për të blerë aktive financiare me mjete monetare;
 - (c) shumat neto për kontrata shkembimi të normave të interesit paguaj - të lëvizshme / merr - fikse, për të cilat këmbehen flukset monetare neto.
 - (d) shumat e kontraktuara për t'u këmbyer në një instrument financiar derivativ (p.sh. një monedhë sëap) për të cilën këmbehen flukset monetare bruto. dhe
 - (e) angazhimet bruto të huasë.
- Flukse të tilla monetare të paskontuara ndryshojnë nga shumat e përfshira në bilanc, sepse shumat në bilanc bazohen në flukset monetare të skontuara.
- B15 Nëse është e përshtatshme, një njësi ekonomike duhet të paraqesë analizën e instrumentave financiarë derivativë veçmas nga ajo e instrumentave financiarë jo-derivativë në analizën sipas kontratës së maturimit për pasivet financiare të kërkuar nga paragrafi 39(a). Për shembull, është e përshtatshme që të dallohen flukset monetare që vijnë nga instrumentat financiarë derivativë dhe instrumentat financiarë jo-derivativë nëse flukset monetare që vijnë nga instrumentat financiarë derivativë janë vendosur për vlerën bruto. Kjo sepse flukset dalëse monetare bruto mund të shoqërohen me një fluks hyrës përkatës.
- B16 Nëse shuma e paguar nuk është fikse, shuma e paraqitur përcaktohet duke ju referuar kushteve ekzistuese në datën e raportimit. Për shembull, nëse shuma e pagueshme është në varësi të ndryshimeve në një indeks, shuma e paraqitur mund të jetë bazuar në nivelin e indeksit në datën e raportimit.

Risku i tregut – analiza e ndjeshmërisë (paragrafët 40 dhe 41)

- B17 Paragrafi 40(a) kërkon një analizë ndjeshmërie për çdo tip të riskut të tregut ndaj të cilit është ekspozuar njësi ekonomike. Në përputhje me paragrafin B3, një njësi ekonomike vendos sesi të bashkojë informacionin për të dhënë një pamje të përgjithëshme pa kombinuar informacionin me karakteristika të ndryshme lidhur me ekspozimin ndaj risqeve të mjedisëve ekonomike shumë të ndryshme. Për shembull:
- (a) një njësi ekonomike që tregton instrumenta financiarë mund të paraqesë këtë informacion veçmas për instrumentat financiarë të mbajtur për tregtim dhe atyre jo-të mbajtur për tregtim.
 - (b) një njësi ekonomike nuk duhet të bashkojë ekspozimin e saj ndaj risqeve të tregut nga zona me hiperinflacion me ekspozimin e saj ndaj të njëjtave risqe të tregut nga zona me inflacion shumë të ulët.
- Nëse një njësi ekonomike është e ekspozuar vetëm ndaj një tipi risku tregu në vetëm një mjedis ekonomik, ajo nuk do të tregojë informacion të veçantë.
- B18 Paragrafi 40(a) kërkon analiza ndjeshmërie për të treguar efektin në fitimin ose humbjen dhe në kapital të ndryshimeve të mundshme të arsyeshme në variablin e riskut përkatës (p.sh. mbizotërimin e normave të interesit të tregut, normave të këmbimit, çmimeve të kapitalit ose të mallrave). Për këtë qëllim:
- (a) njësisë ekonomike nuk u kërkohej të përcaktojnë se çfarë fitimi ose humbje të periudhës do të kishin nëse variablat përkatës të riskut do të kishin qenë të ndryshëm. Në vend të saj, njësitë ekonomike duhet të japin informacion shpjegues për efektin në fitimin ose humbjen dhe kapitalin në datën e bilancit duke supozuar se një ndryshim i mundshëm i arsyeshëm në variablin përkatës të riskut ka ndodhur në datën e bilancit dhe është zbatuar në ekspozimin e riskut që egzistonte në atë datë. Për shembull nëse një njësi ekonomike ka një pasiv me normë të ndryshueshme në fund të vitit, njësi ekonomike duhet të paraqesë efektin e fitimit ose humbjes (d.m.th. shpenzimet e interesit) për vitin aktual nëse normat e interesit kanë ndryshuar me shumën të mundshme të arsyeshme.
 - (b) njësitë ekonomike nuk duhet të paraqesin efektin në fitimin ose humbjen dhe kapitalin për çdo ndryshim brenda një zone ndryshimesh të mundshme të arsyeshme të variablit përkatës të riskut. Dhënia e informacione shpjeguese për efektet e ndryshimeve në kufijtë e zonës së mundshme të arsyeshme do të ishte e mjaftueshme.

- B19 Në përcaktimin se çfarë ndryshimi të mundshëm të arsyeshëm në variablin e rëndësishëm të riskut, një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë:
- (a) mjedisin ekonomik në të cilin ajo operon. Një ndryshim i mundshëm i arsyeshëm nuk duhet të përfshijë skenarë të largët ose “të rastit më të keq” ose “teste stresi”. Gjithashtu nëse norma e ndryshimit në variablin e theksuar të riskut është e qëndrueshme, njësi ekonomike nuk ka nevojë të ndërrojë ndryshimin e mundshëm të arsyeshëm të zgjedhur në variablin e riskut. Për shembull, supozoni se normat e interesit janë 5 për qind dhe një njësi ekonomike përcakton se një ndryshim në normat e interesit prej ± 50 pikë është I mundshëm në mënyrë të arsyeshme. Ajo duhet të paraqesë efektin në fitim ose humbje dhe në kapital nëse normat e interesit do të ndryshonin 4.5 përqind ose 5.5 përqind. Në periudhën e ardhshme, normat e interesit rriten në 5.5 përqind. Njësi ekonomike vazhdon të besojë se normat e interesit mund të ndryshojnë me ± 50 pikë (d.m.th. norma e ndryshimit të interesit është e qëndrueshme). Njësi ekonomike duhet të paraqesë efektin në fitim ose humbje dhe në kapital nëse normat e interesit do të ndryshonin 5 përqind ose 6 përqind. Njësisë ekonomike nuk i kërkohet të rishikojë vlerësimin e saj se normat e interesit mund të kenë ndryshuar në mënyrë të arsyeshme me ± 50 pikë, me përjashtim të rastit kur ka evidencë se normat e interesit janë bërë shumë më të ndryshueshme (lëvizshme).
- (b) harkun kohor gjatë të cilit njësi ekonomike bën vlerësimin. Analizat e ndjeshmërisë duhet të tregojnë efektet e ndryshimeve që janë marrë në konsideratë si të mundshme në mënyrë të arsyeshme gjatë periudhës deri sa njësi ekonomike do të paraqesë përsëri këto dhënie informacionesh shpjeguese, që zakonisht është periudha raportuese vjetore vijuese.
- B20 Paragrafi 41 i lejon një njësi ekonomike të përdorë një analizë ndjeshmërie e cila pasqyron ndërvarësitë mes variablave të riskut, të tilla si një metodologji vlere e rrezikuar, nëse ajo përdor këtë analizë për të manaxhuar ekspozimin e saj ndaj risqeve financiare. Kjo është e zbatueshme edhe nëse një metodologji e tillë mat vetëm mundësinë për humbje dhe nuk mat mundësinë për fitim. Një njësi ekonomike e tillë mund të plotësojë kërkesat e paragrafit 41(a) duke paraqitur tipin e modelit të vlerës së rrezikuar të përdorur (p.sh. nëse modeli bazohet në simulimet Monte Carlo), një shpjegim për mënyrën sesi funksionon modeli dhe supozimet kryesore (p.sh. periudhën e mbajtjes dhe nivelin e besimit). Njësitë ekonomike munden gjithashtu që të paraqesin periudhat historike të vrojtuar dhe matjet e zbatuara për vrojtimit brenda asaj periudhe, një shpjegim sesi janë trajtuar opsionet në llogaritje dhe cilat ndryshime dhe korrelacione (ose ndryshe simulimet Monte Carlo të shpërndarjes së probabilitetit) janë përdorur.
- B21 Një njësi ekonomike duhet të sigurojë analiza ndjeshmërie për të gjitha bizneset e saj, por mund të sigurojë tipe të ndryshme të analizës së ndjeshmërisë për secilën klasë të instrumentave financiarë.

Risku i normës së interesit

- B22 *Risku i normës së interesit* vjen nga instrumentat financiarë bartës të interesit në bilanc, (p.sh. huatë dhe të arkëtueshmet dhe instrumentat e borxhit të emetuara) dhe në disa instrumenta financiarë të panjohur në bilanc (p.sh. disa anagazhime huaje).

Risku i monedhës

- B23 *Risku i monedhës* (ose risku i kursit të këmbimit) vjen nga instrumenta financiarë të cilat janë të shprehur në një monedhë të huaj, d.m.th. në një monedhë tjetër nga monedha funksionale në të cilën ata janë matur. Për qëllimin e këtij SNRF, risku i monedhës nuk vjen nga instrumenta financiarë që janë zëra jo-monetarë ose nga instrumentat financiarë të shprehur në monedhën funksionale.
- B24 Një analizë ndjeshmërie paraqitet për secilën monedhë në të cilën njësi ekonomike ka ekspozimin më të rëndësishëm.

Risku tjetër i çmimit

- B25 *Risku tjetër i çmimit* vjen nga instrumentat financiarë për shkak të ndryshimeve, për shembull në çmimet e mallrave ose çmimet e kapitalit. Për të plotësuar kërkesat e paragrafit 40, një njësi ekonomike mund të paraqesë efektin e një rënie në indeksin e specifikuar të tregut të aksioneve, çmimit të mallrave ose një variabli tjetër të riskut. Për shembull, nëse një njësi ekonomike i jep një vlerë të mbetur garancive që janë instrumenta financiarë, njësi ekonomike paraqet një rritje ose një rënie në vlerën e aktiveve për të cilat zbatohet garancia.
- B26 Dy shembuj të instrumentave financiarë që sjellin risk të çmimit të kapitalit janë (a) mbajtja e kapitalit në një njësi ekonomike tjetër dhe (b) investimi në një trust që në këmbim i mban investimet në instrumenta kapitali. Shembuj të tjerë përfshijnë kontratat e së ardhmes (forëard) dhe opsionet për të blerë ose shitur sasi të caktuara të një instrumenti kapitali dhe kontratat sëpaj që janë të indeksuara me çmimet e kapitalit. Vlera e drejtë e

instrumentave të tillë financiarë ndikohen nga ndryshimet në çmimet e tregut të instrumentave të kapitalit që u përkasin.

- B27 Në përputhje me paragrafin 40 (a) ndjeshmëria e fitimit ose humbjes (që vjen për shembull nga instrumentat e klasifikuar me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes dhe zhvlerësimi i aktiveve financiare gati për shitje) paraqitet veçmas ndjeshmërisë së kapitalit (që vjen, për shembull nga instrumentat e klasifikuar si gati për shitje).
- B28 Instrumentat financiarë që një njësi ekonomike klasifikon si instrumenta kapitali nuk rimaten. As fitimi ose humbja dhe as kapitali nuk do të ndikohen nga risku i çmimit të këtyre instrumentave. Prandaj nuk kërkohet të bëhet analizë ndjeshmërie.